REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 4439

Maliq më 16.07.2026

Projekt-Vendim -NR. 5
Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Nevrus Dushku	F60328024W	Vreshtas	50.000
2	Albert Gongo	H30713013M	Pirg	20.000
3	Artur Risto	H00613045U	Pirg	20.000
4	Armando Selimllari	J31024024T	Pojan	20.000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2026, si më poshtë :

Gr.	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	10430	606	Fondi Social	110.000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petrit

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë
Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 4433 Prot

Maliq më 16.07.2026

Relacion

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1.Nevrus Dushku.

Z. Nevrus Dushku është banor në fshatin Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq. Familja përbëhet nga katër anëtarë: z. Nevrus Dushku, bashkëshortja, vajza e divorcuar, znj. Silvana Dushku, dhe mbesa e mitur.Familja jeton në kushte të vështira social-ekonomike. Të ardhurat e vetme janë pagesa e ndihmës ekonomike dhe pensioni i invaliditetit (KEMP) që përfiton znj. Silvana Dushku. Këto të ardhura janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë të familjes, si edhe shpenzimet e konsiderueshme që lidhen me trajtimin shëndetësor.Pas divorcit, znj. Silvana Dushku është rikthyer të jetojë pranë familjes së prindërve në fshatin Podgorie, së bashku me vajzën e saj të mitur. Ajo është diagnostikuar me sëmundje purpura trombocitopenike trombotike, tumorale (kancer) dhe ka kryer disa ndërhyrje kirurgjikale, si edhe trajtime me kimioterapi. Gjendja e saj shëndetësore kërkon ndjekje të vazhdueshme mjekësore, trajtime periodike, mjekime të kushtueshme dhe kujdes të vazhdueshëm. Sipas rekomandimeve mjekësore, ajo duhet t'i nënshtrohet edhe një ndërhyrjeje tjetër kirurgjikale.Në këto rrethana, z. Nevrus Dushku mban barrën kryesore të përkujdesjes për vajzën e sëmurë dhe mbesën e mitur, duke u përballur me vështirësi të shumta ekonomike dhe sociale. Gjendja e familjes është rënduar ndjeshëm si pasojë e kostove të larta të trajtimit mjekësor dhe pamundësisë për të siguruar të ardhura të tjera. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

2.Albert Gongo.

Z. Albert Gongo është banor i fshatit Sovjan, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq. Familja e tij përbëhet nga pesë anëtarë: z. Albert Gongo, bashkëshortja e tij, znj. Eriola Gongo, dhe tre fëmijët.Sipas verifikimeve dhe informacionit,familja ndodhet në kushte të vështira social-ekonomike. Që prej vitit 2020, familja jeton në banesën e nënës së z. Albert Gongo, pasi banesa e tyre është shkatërruar si pasojë e një zjarri. Banesa ku ata banojnë aktualisht është e amortizuar dhe nuk plotëson kushtet e përshtatshme për një jetesë normale.Gjendja ekonomike e familjes është e rënduar. Bashkëshortja e z. Albert Gongo vuan nga probleme shëndetësore që e pengojnë të ushtrojë një aktivitet pune. Për shkak të nevojës për t'u kujdesur për bashkëshorten e sëmurë dhe për nënën e tij të moshuar, z. Albert Gongo nuk ka mundësi të punojë me kohë të plotë, duke bërë që të ardhurat e familjes të jenë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë të jetesës. Familja has vështirësi në sigurimin e shpenzimeve të përditshme, si dhe në përballimin e kostove që lidhen me arsimimin fëmijëve.Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

3.Artur Risto.

Z.Artur Risto është banues në fshatin Zvirinë, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq. Familja përbëhet nga dy anëtarë, kryefamiljari dhe vajza e tij.Nga informacioni i administruar në terren, rezulton se familja jeton në kushte të vështira social-ekonomike. Të ardhurat e familjes janë tepër të kufizuara, pasi e vetmja e ardhur e rregullt është përfitimi nga skema e ndihmës ekonomike. Kjo shumë është e pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet minimale të jetesës.Gjendja ekonomike e familjes vazhdon të mbetet e rënduar, duke e bërë të pamundur sigurimin e një standardi normal jetese. Për shkak të mungesës së burimeve të tjera financiare dhe pamundësisë për të përmirësuar të ardhurat, familja është ndër familjet që kanë nevojë të vazhdueshme për mbështetje sociale dhe institucionale. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

4.Armando Selimllari.

Z.Armando Selimllari është banues në fshatin Orman, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.Familja e tij përbëhet nga gjashtë anëtarë.Në përbërje të saj janë katër fëmijë, nga të cilët dy janë nga martesa e parë, për të cilët kujdestari ligjor është z.Armando, ndërsa dy fëmijët e tjerë janë nga martesa aktuale.Kryefamiljari Armando është i papunë dhe nuk disponon të ardhura të qëndrueshme nga punësimi. Burimi i vetëm i të ardhurave të familjes është mbledhja dhe shitja sezonale e bimëve medicinale, të ardhura të cilat janë të pamjaftueshme për të siguruar plotësimin e nevojave bazë të familjes.Bashkëshortja znj.Nertila paraqet probleme shëndetësore

në njërën dorë, gjendje e cila i kufizon aftësinë për të kryer punë fizike dhe për t'u angazhuar në aktivitete që do të mundësonin sigurimin e të ardhurave shtesë për familjen.Nga vlerësimi i situatës socio-ekonomike rezulton se familja jeton në kushte të vështira ekonomike dhe sociale, me të ardhura të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat jetike të të gjithë anëtarëve. Gjendja ekonomike rëndohet më tej nga papunësia e kryefamiljarit, problemet shëndetësore të bashkëshortes dhe përgjegjësia për rritjen dhe mirëqenien e katër fëmijëve. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi
Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale	J.Hoxha	
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale	E.Petriti	

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ